



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 7649 prot.
2

Tiranë, më 03.11.2017

U R D H Ë R

Nr. 2024, datë 03.11.2017

**PËR
PROCEDURAT DHE AUTORITETET PËRGJEGJËSE PËR DHËNIEN E LEJES
PËR USHTARAKËT AKTIV PËR DALJEN JASHTË VENDIT PËR ARSYE
PRIVATE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar; të shkronjës “f”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”; nenit 19, të ligjit nr. 9210, datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 113 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”,

U R D H Ë R O J:

1. Për marrjen e lejes, për të gjitha daljet jashtë vendit për shkaqet e parashikuara nga gërma “ç”, pika 1 e nenit 19 të ligjit nr.9210/2003, ushtaraku t’i paraqesë komandantit/drejtuesit të institucionit ku shërben, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara, kërkesën për marrjen e lejes.
2. Kërkesa për marrje leje të jetë sipas formularit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij urdhri.
3. Në kushtet e rrethanave të urgjencës së jashtëzakonshme, për probleme shëndetësore të ushtarakut ose pjesëtarëve të familjes së tij apo hidhërimeve në rrethin e ngushtë familjar, autoritetet përgjegjëse kanë të drejtë të japin leje të menjëhershme, pa iu nënshtruar procedurave normale, kur:
 - a. koha normale e përgatitjes së praktikës për dalje jashtë vendit rëndon gjendjen shëndetësore të ushtarakut ose të pjesëtarëve të familjes së tij;
 - b. koha normale e përgatitjes së praktikës për dalje jashtë vendit nuk premtton marrjen pjesë në ritet mortore.

4. Praktika shkresore për miratim leje për jashtë vendit, edhe në kushtet e urgjencës, të vazhdojë procedurën e miratimit, si në rastet e zakonshme.
5. Autoritetet përgjegjëse për dhënie leje për dalje jashtë vendit, për ushtarakët aktiv të Forcave të Armatosur të Republikës së Shqipërisë të jenë, si më poshtë:
 - a. **Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ose personi i autorizuar prej tij** – për të gjithë komandantët e Forcave, komandantët e Komandës Mbështetëse dhe KDS-së, si dhe komandantëve të reparteve në vartësi të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm.
 - b. **Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe në mungesë të tij drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura** – për ushtarakët në strukturën e Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm të FA-së dhe kabinetin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm.
 - c. **Komandantët e Forcave/Komandave/Njërive/Reparteve/strukturave autonome** – për personelin në vartësi të tyre, i cili nuk është i përfshirë në pikat “a” dhe “b”, më sipër.
6. Miratimi i kërkesës së paraqitur nga ushtaraku ose refuzimi i saj të bëhet brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike, nga paraqitja e kërkesës. Përgjigjja për miratim ose refuzim të kërkesës t’i dërgohet menjëherë kërkuarit. Refuzimi i kërkesës të bëhet i arsyetuar në çdo rast.
7. Komandantët e Forcave, Komandave dhe Njërive, në informacionin mujor, të përfshijnë edhe praktikën sipas Aneksit A, bashkëngjitur.
8. Drejtoria/dega/seksioni i personelit, t’i bashkëlidhë praktikës për miratimin e lejes për dalje jashtë vendit për e parashikuar në pikën 1 të këtij urdhri, planin e shpërndarjes, si më poshtë:
 - a. kopja e sigluar të qëndrojnë në sekretari;
 - b. kopja tjetër t’i dërgohet strukturës, pjesë e të cilës është ushtaraku, të cilit i miratohet ose i refuzohet leja;
 - c. një kopje e skanuar ti dërgohet në mënyrë elektronike Policisë Ushtarake dhe Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në adresën e deklaruar për këtë qëllim;
9. Komandantët e Forcave, Komandave dhe Njërive, Policia Ushtarake dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të deklarojnë një adresë elektronike në rrjetin e klasifikuar për realizimin e korrespondencës së nevojshme.
10. Personeli ushtarak që del jashtë vendit për arsye private, të plotësojë formularin nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij urdhri, për marrje leje për dalje jashtë vendit.
 - a. Drejtoria/dega /seksioni i personelit të vlerësojë kërkesën e bërë nga ushtaraku, për leje dalje jashtë vendi, sipas kërkesave të formularit nr. 1 dhe të përgatisë praktikën për autoritetin përgjegjës. Praktika e miratimit të kalojë nga drejtoria /dega/seksioni i zbulimit.

11. Pas kthimit nga leja, ushtaraku është i detyruar të raportojë sipas formularit nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij urdhri.
- a. Për rastet që gjatë kohës së qëndrimit jashtë vendit për arsye private, ushtaraku ka raportuar se ndaj tij është tentuar të kryhen kontakte apo veprime të dyshimta, që kanë të bëjnë me cenimin e sigurisë së tij, të Forcave të Armatosura apo sigurisë kombëtare, strukturat e zbulimit të repartit/njesisë/forcës të raportojnë me shkrim në Drejtorinë e Zbulimit në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
 - b. Drejtoria e Zbulimit në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, të evidentojë informacionin e ardhur nga strukturat e zbulimit të FA-së dhe ta përcjellë zyrtarisht për kompetencë në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
 - c. Drejtoria/dega/seksioni i zbulimit të mbajë database-in për personelin që i miratohet leja e daljes jashtë vendi, sipas Aneksit A bashkëlidhur;
 - d. Policia Ushtarake të monitorojë daljet e ushtarakëve jashtë vendit dhe kthimin e tyre nëpërmjet sistemit TIMS. Për rastet e shkeljeve të rregullave të përcaktuar në këtë urdhër dhe të raportojë në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së;
 - e. Kërkesës për miratim leje jashtë vendit, t'i bashkëngjitet në çdo rast prononcimi i komandantit të strukturës (pro/kundër), në të cilën bën pjesë ky personel.
12. Në rastet kur kërkesa adresohet për në vendet në konflikt dhe ato jo miqësore me Shqipërinë dhe Aleancën, për miratimin e saj të kërkohet mendimi i organeve ligj zbatuese në FA (PU dhe AISM).
13. Me këtë urdhër të njihet i gjithë personeli ushtarak i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura.
14. Përgjigjen për zbatimin e këtij urdhri strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura.
15. Ndjek zbatimin e urdhrit Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe komandantët e forcave dhe strukturave mbështetëse.
16. Urdhri nr. 343, datë 02.03.2015 "Për procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për dhënien e lejes për ushtarakët aktivë për daljen jashtë vendit për arsye private", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



**KËRKESË
PËR LEJE DALJE JASHTË SHTETIT**

Unë i nënshkruari _____, me gradë _____, me
(emër, mbiemër)

detyrë funksionale _____, në _____,
(emërtimi i detyrës) (drejtoria/njësia/reparti)

me dokument identifikimi nr. _____, bazuar në urdhrin e Ministrit të
(nr. personal)

Mbrojtjes, nr. _____ datë _____. 2017 "Për procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për
dhënien e lejeve për ushtarakët aktiv që shkojnë për pushime, vizita tek të afërmit dhe për

arsye të tjera private të tyre jashtë vendit", kërkoj leje që, për periudhën nga

data _____. _____. _____ deri në datën _____. _____. _____, të shkoj në

_____ për :
(emri i shtetit)

☐ Pushime: ☐ Vizitë tek të afërmit: ☐ Arsye të tjera private:

(specifiko detajet më poshtë):

(adresa/adresat dhe nr. kontakti i arritshëm gjatë qëndrimit jashtë shtetit)

Mënyra e udhëtimit do të jetë: _____
(rrugë ajrore, detare, tokësore ose me automjet privat)

Lutemi miratimin Tuaj.

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

_____ më, _____. _____. _____

RAPORTIM KOMANDE

GRADA _____

EMRI _____

MBIEMRI _____

ATËSIA _____

DATËLINDJA _____

VENDLINDJA _____

DETYRA _____

FORCA/REPARTI _____

DATA E NISJES _____

DATA E KTHIMIT _____

ADRESA E PLOTË E QËNDRIMIT _____

ARSYEJA E MARRJES SË LEJES _____

Shefi i degë/seksioni së personelit të Forcës/Repartit

Grada

Emri

Mbiemri

Firma



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA

Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____. _____. _____. _____

DEKLARATË

Unë i nënshkruari _____, me detyrë _____ në _____, deklaroj nën përgjegjësinë time, se gjatë qëndrimit tim jashtë shtetit për arsye private, të miratuar sipas kërkesës me nr. protokolli _____, datë _____:

- ☐ **Nuk kam pasur** raste, kontakte, aktivitete, indikacione apo sjellje nga persona të dyshimtë, që treguan interes për FA, personelin e tyre, informacionin e klasifikuar, kapaciteteve operacionale, objekteve dhe aktiviteteve, të cilat ndikojnë në sigurinë kombëtare të RSH.
- ☐ **Kam pasur** raste, kontakte, aktivitete, indikacione apo sjellje nga persona të dyshimtë që treguan interes për FA, personelin e tyre, informacionin e klasifikuar, kapaciteteve operacionale, objekteve dhe aktiviteteve, të cilat ndikojnë në sigurinë kombëtare të RSH.
- ☐ **Rrethana të tjera:**

Jepni hollësira dhe sqaroni rrethanat(pse, ku dhe si).

Nëse unë nuk kam raportuar rastet, kontaktet, aktivitetet, indikacionet apo sjelljet e dyshimta me persona të dyshimtë që treguan interes për FA, personelin e tyre, informacionin e klasifikuar, kapaciteteve operacionale, objekteve dhe aktiviteteve, të cilat ndikojnë në sigurinë kombëtare të RSH, do të jem subjekt i veprimeve juridike ose administrative, ose të dyja bashkë, në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi.

Deklaruesi

Struktura e Zbulimit

Nënshkrimi

Nënshkrimi